



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr. 359/Prot.

Datë 18.07.2023

23

VENDIM

Nr. 1003, Datë 18.07.2023

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Objekt: Largim nga funksioni dhe përfundim i marrëdhënies së punës si Sekretare e Përgjithshme e Autoritetit të Konkurrencës i znj. Diana Dervishi.

Shpallja e vakancës për funksionin Sekretar i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës dhe nisjen e procedurës për plotësimin e pozicionit.

Bazë ligjore: Neni 24 dhe 27, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pasi shqyrtoi shkresën nr. 359/19 prot, datë 17.07.2023 të znj. Diana Dervishi,

VËREN SE:

Me anë të kësaj shkrese, Autoriteti i Konkurrencës, është vënë në dijeni nga znj. Diana Dervishi, me funksion Sekretare e Përgjithshme e Autoritetit të Konkurrencës (emëruar me Vendimin nr.178 prot., datë 5.05.2005 të Komisionit të Konkurrencës), se ajo me dëshirë ka kërkuar (citojmë) “ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil me Autoritetin e Konkurrencës [...] për shkak të emërimit dhe fillimit të marrëdhënieve të punës në një pozicion jashtë shërbimit civil”.

Në shkresën e depozituar nga znj. Dervishi me nr.359/17 prot., datë 17.07.2023 znj. Dervishi ka bashkëngjitur edhe shkresën nr.2288 prot, dt. 14.07.2023 të Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë, nga e cila rezulton se, me Urdhërin nr.75, datë 14.07.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z.Artur Metani, urdhërohet: 1) emërimi i znj. Diana Dervishi në detyrën e Këshilltarit të Kabinetit të ILD dhe 2) marrëdhëniet financiare të fillojnë më datë 17.07.2023.

Komisioni i Konkurrencës pas verifikimit dhe shqyrëtimit të fakteve të mësipërme si dhe bazuar në kompetencat e parashikuara në Ligjin nr.9121 dt. 28.07.2003, (nenet 24 dhe 27) vlerësoi se, bazuar në sa më sipër, marrëdhënia e punës e znj. Diana Dervishi me Autoritetin e Konkurrencës konsiderohet e përfunduar si pasojë e veprimeve të njëanshme

të znj. Diana Dervishi, të cilat kanë konkluduar me emërimin në një pozicion tjetër pune jashtë Autoritetit të Konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE:


Komisioni i Konkurrencës, bazuar në kompetencat e përcaktuara në nenet 24 dhe 27 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,


VENDOSI:


- I. Largimin nga funksioni i Sekretares së Përgjithshme të Autoritetit të Konkurrencës së znj. Diana Dervishi dhe përfundimin e marrëdhënies së saj të punës me Autoritetin e Konkurrencës.
- II. Përfundimin e marrëdhënies financiare nga data 17.07.2023.
- III. Shpalljen e vakancës për funksionin “Sekretar i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës” dhe nisjen e procedurës për plotësimin e pozicionit.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA

Zv/Kryetar

Rezana KONOMI

Anëtar

Adriana BERBERI

Anëtar

Durim KRAJA

Anëtar

